



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr.12-320-9873 të datës 21.02.2020 ,duke vendosur sipas kërkesës së Alma Bytyqit nga Sllovia, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE**

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 350 € (treqind e pesëdhjetë euro), Alma Bytyqit nga Sllovia, sipas kërkesës së saj të datës 12.05.2020 për ta mbështetur financiarisht dhe kompenzuar njëkohësisht për dëmin e shkaktuar nga parazitët në bletishten e saj konform Procesverbalit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari Nr.12-320-17622 të datës 13.05.2020.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në xhironlogarinë bankare XKO51401000013980013 në Bankën Ekonomike.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjellë dëshmi-faturë dhe të njëjtat të dorëzojë në Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Alma Bytyqi nga Sllovia

1Nr. 320-17822

Lipjan, më 20.05.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

